



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d), 40.2 shkronja c), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, neneve 2 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, nenit 30.3 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë nr.03/L-048, nenit 16 paragrafët 2 dhe 9 të Ligjit nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, dhe nenet 15 paragrafi 2.4, nenit 34 paragrafi 2.3, të Statutit të Komunës, nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, dhe sipas konstatimeve të rekomanduara nga Komiteti për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 05 shtator 2018, miratoi,

### VENDIM

#### PËR RIALOKIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2018

##### Neni 1

Rialokimi i mjeteve nga granti qeveritar dhe të hyrat Vetanake - 10 dhe 21, për Investime Kapitale - 30.

##### 1.1. Nga programi 66030 – Planifikim Hapësinor dhe Rregullativ, kodi funksional - 0620, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:

Ndërtimi i Bulevardit dhe Sheshit “Sheshi i Dëshmorëve” (Zahir Pajaziti, Hakif Zejnullahu, Ilir Kunushëfci, Ali Ajeti) në qendër të qytetit, kodi - 46937, shuma.....743,000 €

##### Rialokohet në:

- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Balloc, kodi-46159, shuma.....6,500 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llapashticë e Epërme, kodi-46437, shuma..... 9,900 €
- Asfaltimi i rrugës në fshatin Bellopojë, kodi-43161, shuma.....12,900 €
- Ndërtimi, shtimi, rritja dhe mirëmbajtja (në pronën publike të qytetit), kodi-46390, shuma .....10,000 €
- Zgjerimi, ndërtimi dhe asfaltimi i rr. ”Zahir Pajaziti” dhe “Skenderbeu” në qytet, kodi-44621, shuma..... 608,700 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Dyz, (Lagjet Maloku dhe Berisha), kodi-44658, shuma..40,000 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Siboc (te Xhamia e vjetër), kodi-46150, shuma .....30,000 €
- Asfaltimi i disa rrugëve në fshatin Llugë (Lagja Zhitia), kodi-45949, shuma.....25,000 €

**1.2. Nga programi 18165 – Infrastruktura Publike, kodi funksional - 0451, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:**

Rregullimi i infrastrukturës së varrezave, kodi-44644, shuma.....	15,500 €
Shenjëzimet horizontale dhe vertikale, kodi- 85202, shuma.....	24,000 €
Kanalizim fekal në Dyz- vazhdim, kodi-40296, shuma.....	23,500 €
Kanalizim fekal Pakashticë e Epërme, kodi-89318, shuma.....	23,580 €
Rregullimi i hapësirave publike, kodi-46388, shuma.....	19,500 €
Ndërtimi i urave (Pollatë,Sfeçel,Miroc,Murgull,Batllavë,Zakut), kodi-46087, shuma.....	11,000 €
Riparimi i infrastrukturës përcjellëse në rrugët e asfaltuara (kanalizim atmosferik, bankinat, kalesat etj.) kodi-46109, shuma.....	66,000 €

**Rialokohen në:**

- *Kanalizim fekal në qytet dhe fshatra, kodi- 43129, shuma.....* 119,280 €
- *Riparimi dhe ndërtimi i urave, kodi-85212, shuma.....* 38,500 €
- *Meremetimi i rrugëve me zhavorr, kodi-85214, shuma.....* 15,500 €
- *Ndërtimi i trotuareve në; (qytet, fshatrat Kërpimeh, Dumnicë, Peran rr. "Llapi", Shajkoc), kodi-46336, shuma.....* 9,800 €

**1.3. Nga programi 18165 – Infrastruktura Publike, kodi funksional - 0451, Fondi burimor - 21, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:**

Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit, kodi-85209, shuma.....	7,500 €
Ndërtimi i stacioneve të udhëtarëve, kodi-40280, shuma.....	17,000 €

**Rialokohen në:**

- *Kanalizim fekal në qytet dhe fshatra, kodi- 43129, shuma.....* 15,000 €
- *Meremetimi i rrugëve me zhavorr, kodi-85214, shuma.....* 9,500 €

**1.4. Nga programi 85005 - Shërbimet kulturore, kodi funksional - 0820, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:**

Zërimi profesional, kodi-46462, shuma.....	410 €
--	-------

**Rialokohet në:**

- *Ndërtimi i fushave të hapura sportive nëpër fshatra, kodi-45937, shuma.....* 410 €

**1.5. Nga programi 85005 - Shërbimet kulturore, kodi funksional - 0820, Fondi burimor - 21, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi - 30:**

Renovimi i sallës së Teatrit, kodi-46410, shuma.....13,000 €

**Rialokohet në:**

- *Ndërtimi i fushave të hapura sportive nëpër fshatra, kodi-45937, shuma.....13,000 €*

**1.6. Nga programi 73300 – Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor, kodi funksional - 0721, Fondi burimor - 10, kategoria ekonomike Investime kapitale, kodi -30**

Pajisje mjekësore, kodi-43187, shuma.....50,000 €

**Rialokohet në:**

- *Renovimi i objekteve shëndetësore, kodi-85257, shuma.....50,000 €*

**Neni 2**

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-016/01-0073356/18  
Podujevë,  
05 shtator 2018



**Kryesuesi i Kuvendit  
Fahmir Gashi**